

## **Psycho-Linguistic Development of the Child: The Role of Early Experience**

Hulya Skuka (Phd), Faculty of pedagogy, St.Kliment Ohridski- Skopje (NRM);  
Lulzim Murtezani (Phd),  
Department of Psychology, University of Tetova (NRM).  
Corresponding Author: Hulya Skuka (Phd)

---

**Abstract:** People have always glorified their oratory abilities, stressing that language are what make them different from the other species. The language is a very sophisticated achievement in the process of development, with a purpose for the children to understand communication in a perfect way. Psycholinguists claim that the first years from the life are of crucial importance for the proper development of the child's language. The language reflects the social and cultural background of the individual. In this paper we will analyze the patterns of development of the child's language and stress that all children have similar models of development regardless of the cultural diversity. Among other things, we will also analyze the social model of speech, which is very important for the language and dialect in which the child will learn, and the intellectual, emotional and ethic attitude for verbal expression that it will form. The learning of a language cannot be explained only by referring to social models. The more human speech is researched, the more the complex nature of the language of interpersonal communication is stressed. The psycholinguistic theory of Chomsky has a great contribution in this field. He considers that the children all over the world are biologically prepared (possess universal human grammar) for learning the language of the adults. His explanations are an important guideline for cultivation of the verbal abilities of the children and for discovery of the secrets of the language sophistication of the children. The development of the speech ability, i.e. the enrichment of the verbal fund and the symbolic functions is a serious obligation that the adults have in the education of children. In this paper, we will present several important recommendations that need to be implemented and we conclude by discussing key findings and identifying issues for further research .

**Keywords:** critical period, language exposure, models of the social speech, universal grammar.

---

Date of Submission: 15-04-2019

Date of acceptance: 01-05-2019

---

### **Abstrakt**

Njerëzit gjithmonë i kanë thurur lavdi aftësisë së tyre për të folur, me arsytim se ajo që i dallon nga gjithë speciet tjera është pikërisht gjuha. Kur ne studiojmë gjuhën njerëzore, tërhiqte vëmendjen Noam Çomski, i qasemi asaj çka disa e quajnë 'esenca njerëzore' e cilësive të mendjes, që janë, për sa dimë ne deri tani, unike tek njerëzit (Feldman, 1997). Gjuha është arritje shumë e sofistikuar e procesit të zhvillimit, një pjesë e së cilës është suksesi në rritje të fëmijëve për të realizuar një komunikim gjithnjë e më të përsosur. Psikolinguistët pohojnë se vitet e para të jetës janë kritike për sa i takon zhvillimit të drejtë gjuhësor të fëmijës (Berko, 1958). Përderisa gjuha reflekton sfondin social kulturor të jetës së individit, në punim do të analizohen modelet e zhvillimit të folurit të fëmijëve me ç'rast do të theksohet fakti sipas të cilit të gjithë fëmijët hasen modele të tilla ngjashme pavarësisht kulturës që i përkasin. Gjithsesi do të shqyrtohet modeli i folurit social nga i cili shumë varet se cilën gjuhë dhe dialekt fëmija do të mësojë dhe si do të formohet raporti (qëndrimi) intelektual, emocional dhe etik ndaj të shprehurit verbal. Përvetësimi gjuhësor nuk mund të reduktohet vetëm duke u thirrur në modelet sociale. Sa më shumë që hulumtohet folurit e njeriut aq më shumë kuptohej natyra komplekse e gjuhës së komunikimit ndërnjerëzor. Një ndihmesë të madhe, në këtë drejtim, dha teoria psikolinguistike e Chomsky-it (1965). Ky autor konsideron se fëmijët e mbarë botës janë të përgatitur biologjikisht (posedojnë bazë nervore të një gramatike universale njerëzore) për të përvetësuar gjuhën e të rriturve. Për të zbuluar sekretet e sofistikimit gjuhësor të fëmijëve, shpjegimet e tij paraqesin një udhërrëfyes të rëndësishëm në kultivimin e aftësive verbale të të vegjëleve. Zhvillimi i aftësisë së folurit, përkatësisht pasurimi i fondit foljor dhe të gjitha funksioneve simbolike, paraqet një detyrë serioze të të rriturve në edukimin e fëmijëve. Në këtë plan do të theksohen disa nga rekomandimet më të rëndësishme që duhet zbatuar.

**Fjalët kyçe:** Periudha kritike, ekspozimi gjuhësor, modelet e folurit social, gramatikë universale.

## Hyrje

Në shkencën e psikologjisë, rëndësi të madhe i atribuohet të kaluarës së individit. Për të arritur të kuptojmë si silllet aktualisht një person domosdo të njohim të eksperiencën e tij veçanërisht në fëmijëri (S. Freud). Një segment i sjelljes së individit është aftësia e komunikimit verbal (dhe jo verbal). Të shqyrtojmë të folurit nga një retrospektivë në fakt është synimi i punimit aktual. Nga kjo logjikë për të kuptuar nivelin e të folurit të nxënësve dhe të studentëve, nxënësve dhe për të influencuar atë, do të na ndihmojnë shumë njohuritë mbi eksperiencat gjuhësore të tyre që nga mosha e fëmijërisë.

Studentet janë të vetëdijshëm për vështirësitë në të cilat hasin gjatë përvetësimit të gjuhës së huaj. Pyetja që shtrohet në këtë kontekst është si ka mundësi që i njëjti student në vitet e para të jetës në të shumtën e rasteve arrin të mësoj gjuhën e tij amtare me lehtësi, madje pa tekste ose instruktor të veçantë dhe fare pa studiuar? Sot shkencëtarët ndajnë mendimin se në përvetësimin e gjuhës rolin kryesor e kanë faktorët biologjik dhe ata të mjedisit - bashkëveprimi social, që rezultojnë në eksperiencat të ndryshme gjatë procesit të mësuarit të gjuhës kombëtare të fëmijës. Në rast se ato përvoja janë pozitive mbase i rrituri do të jetët me personalitet me stabël, dhe e kundërta – më i pasigurt. Ngjashëm, eksperiencat verbale e pasur rrit probabilitetin e të shprehurit të begatshëm, nivelit të lartë të retorikës dhe të të menduarit të zhvilluar, gjë që nuk mund të themi në rast se eksperiencat gjuhësore në fëmijëri është e zbehtë për shkak të shumë rrethanave të pavolitshme familjare: traumat në fëmijëri, abuzimi e neglizhenca, varfëria e skajshme, stresi, konfliktet dhe dhuna.

Një mjedis i kontaminuar gjuhësor (P.sh., gjuhë e bastarduar e të rriturve), do të devijojë përvetësimin e drejtë të gjuhës të fëmijës sidomos në rrethana të stërngarkimit gjuhësor: derisa mëson nga dialekti, gjuha e letrare dhe ajo e huaj. Si rezultatet interferencash gjuhësore do të shfaqet një konfuzion në të shprehurit e fëmijës, në artikullimin e tingujve dhe përvetësim të ngadalshëm të gjuhës .

Prandaj në të folurit e fëmijëve dhe adoleshentëve hasim në dominim të lartë të fjalëve të huaja dhe jo adekuate për natyrën e gjuhës shqipe.

## I. DIÇKA LIDHUR ME GJËEGJËZËN E GJUHËS NJERËZORE

**Gjuha** - fjalët që themi, shkruajmë apo i shprehim në formë gjestesh dhe mënyrat se si ne i kombinojmë teksta mendojmë dhe komunikojmë, paraqet shëmbëllim të gjallë të të menduarit njerëzor. Njerëzit gjithmonë i kanë thurur lavdi aftësisë së tyre për të folur, me arsyetim se ajo që i dallon nga gjithë speciet tjera është pikërisht gjuha. Kur ne studiojmë gjuhën njerëzore, tërhiqte vëmendjen Noam Çomski, i qasemi asaj çka disa e quajnë 'esenca njerëzore' e cilësive të mendjes, që janë, për sa dimë ne deri tani, unike tek njerëzit (Feldman, 1997). Për shkencëtarin kognitiv Steven Pinker (1990), gjuha është 'margaritari në kurorën e njohjes'. Kur trakti zanor njerëzor zhvilloi aftësitë për të shqiptuar tingujt, aftësia jonë për gjuhën shpërtheu, duke e katapultuar specien tonë shumë përpara (Diamond, 1089). Sjellja verbale shfaqet në saje të një hapi kritik në evoluimin e specieve njerëzore, kur muskulatura vokale bëhet e aftë ndaj kushteve operuese. Varësisht nëse është e folur, e shkruar, apo shenjtore, gjuha na mundëson komunikimin e ideve të ndërlikuara nga një njeri tek tjetri dhe transmetimin e njohurive të akumuluaras përmes gjeneratave. Në vija të përgjithshme me termin komunikim, përshkruhet procesi me anë të të cilit njerëzit shkëmbejnë informacione me njëri - tjetrin. Informacionet përfshijnë një gamë të gjerë të të dhënave të tilla si simbole, gjendje emocionale, njohuri shkencore, porosi, dhe ide të ndryshme. Mënyrat e bartjes së tyre janë dy llojesh: verbale (nëpërmjet gjuhës së shkruar dhe të folur), nëpërmjet simboleve (p.sh., shenjat e trafikut); dhe jo verbale: nëpërmjet gjuhës së trupit-gjesticulacionit.

Ata që merren me studimin e mësimin të gjuhës hamenden rreth mënyrës se si arrihet një gjë e këtyllë. Përpjekjet për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje kanë ndezur polemika mes studiuesve. Polemika zhvillohet edhe për pikëpamjen bibehavioriste të organizmave të adaptueshëm, kundrejt pikëpamjes që konsideron se çdo organizëm është biologjikisht i përgatitur për të mësuar disa sjellje të caktuara. Nga debatet akademike rezultuan teori të ndryshme që synonin të zbërthenin çështjen komplekse të përvetësimit të gjuhës nga ana e qenieve njerëzore.

Roli i të mësuarit është i pakontestueshëm në zhvillimin gjuhësor. Për të mësuar një gjuhë, fëmijët duhet të jenë në mjedis ku ka edhe njerëz të tjerë. Psikologu B. Skinner (1957), gjatë shpjegimit të zhvillimit gjuhësor të fëmijëve, bazohej në konceptin e përforcimeve. Sipas tij, prindërit vazhdimisht i inkurajojnë fëmijët e tyre të sajojnë tinguj adekuat të gjuhës që e flasin. Megjithatë, zhvillimi gjuhësor i fëmijës realizohet edhe nëpërmjet procesit të imitimit. Vokabulari i prindërve imitohet nga më të vegjlit. Gjithashtu, fëmija e përvetëson të folurit edhe në bazë të mësuarit me kushtëzim. I njohur si bibehaviorist i devotshëm, Skinneri besonte se zhvillimi i gjuhës mund të shpjegohet me parimet e njohura të të mësuarit, sikurse bashkëlidhja (asociacioni) e pamjeve të gjësendeve me tingujt e fjalëve; imitimin e fjalëve dhe sintaksën e modeluar nga të tjerët dhe përforcimin (me suksesin, buzëqeshjen dhe përqafimet pasi fëmijët saktësojnë diçka).

Sa më shumë që hulumtohet të folurit e njeriut aq më shumë kuptohej natyra komplekse e gjuhës së komunikimit ndërnjerëzor. Psikolinguistët e kishin të qartë se të përvetësuarit e rregullave gramatikore nuk mund të shpjegoheshin vetëm në saje të përforcimit dhe imitimit (të mësuarit). Ishte më se e nevojshme një

qasje tjetër për sa i përket sqarimit të ecurisë së zhvillimit të folurit. Një ndihmesë të madhe, në këtë drejtim, dha teoria psikolinguistike e Çomskit (Noam Chomsky, 1965). Ky autor konsideronte se fëmijët e mbarë botës janë të përgatitur biologjikisht (posedojnë bazë nervore të një gramatike universal njerëzore) për të përvetësuar gjuhën e të rriturve.

Nje studiuës tjetër, Piazhë (Piaget, 1971),pos që trajtoi zhvillimin kognitiv, Piazhëu u përpoq të zbërthente edhe zhvillimin e gjuhës. Piazhë ishte i bindur se zhvillimi i gjuhës nuk rezulton nga një tabelë biologjike, por më tepër nga ekzistenca e strukturave kognitive dhe në harmoni me nevojat e fëmijës. Vepra kryesore e Piazhëut për gjuhën 'Gjuha dhe mendimi I fëmijës' ('The language and the thought of the Child'), fillon me pyetjen: 'Cilat janë nevojat që një fëmijë synon të plotësojë duke folur?' Që do të thotë, cili është funksioni i gjuhës për një fëmijë?

## II. RAPORTI NDËRMJET GJUHËS DHE TË MENDUARIT

Bota pa gjuhët, do të ishte botë pa koncepte. Gjuha ndikon mbi mënyrën se si mendojmë, perceptojmë dhe kujtojmë. Arsimiti, për rrjedhojë, synon të rrisë fuqinë e fjalës dhe të mendimit. Megjithatë, shumë nga të menduarit nuk përfshijnë fjalë. Të menduarit dhe gjuha ndërlihen në mënyrë të ndërlikuar. Pyetja se cila prej tyre vjen e para, për psikologjinë është si "pyetja e vezës dhe e pulës". A vijnë idetë tona të parat dhe presin që të vijnë fjalët dhe t'u japin atyre emra? Apo, janë mendimet tona të ngjizura me fjalët dhe të pamenduara pa to? Të menduarit dhe gjuha janë cilësitë themelore që i siguruan privilegjin më të lartë qenies njerëzore. Raporti ndërmjet gjuhës dhe të menduarit është i ndërsjellë. Teoricienë sferash të ndryshme shkencore janë përpjekur të shpjegojnë ndërlihdjen midis gjuhës dhe të menduarit. Njëra prej tyre është e ashtuquajtura: **teoria e relativitetit gjuhësorë**.

A ndikon gjuha në të perceptuarit e realitetit? A thua njerëzit, përkundrejt faktit se merren me të njëjtin realitet, atë e shikojnë ndryshe? Pyetje të këtilla e sfiduan shkencëtarin Benxhamin Uorf (sipas, Pettijoonh, 1996), për të përpunuar hipotezën e relativitetit gjuhësor. Sipas hipotezës së relativitetit gjuhësor të Uorfit, gjuhë të ndryshme imponojnë konceptime të ndryshme të realitetit: 'Gjuha formëson mendimet bazë të njeriut'. Hopët (indianë të Amerikës Nga ana tjetër, në jetën e përditshme, ju mund të hasni raste në të cilat ka mundësi të dëshmohet koncepti i Uorfit. Në të folurit e përditshëm kemi disa fjalë të cilat ndikojnë, ndonjëherë, gabimisht në perceptimin e gjërave. Për shembull, nëse themi motër medicinale, do të ishte qesharake të përfytyrojmë një mashkull në atë rol; ose fjala mekanik na bën të mendojmë sesi ky profesion është i destinuar vetëm për meshkuj!

Fuqia e gjuhës për të ndikuar mbi të menduarit e bën procesin e krijimit të fjalorit një pjesë të rëndësishme të arsimit. Sot shumë autorë pohojnë se zhvillimi i gjuhës (zgjerimi i saj), zhvillon aftësinë e të menduarit. Sot pranohet se gjuha nuk e determinon të menduarit, por ajo e influencon atë.

## III. ECURIA PËRVETËSIMIT TË GJUHËS

Belbëzimi mbledh tingujt karakteristikë dhe intonacionin e përdorur në një mjedis familjar ku rritet foshnja. Në kohën që foshnjat janë rreth dhjetë muaj, belbëzimi i tyre ka ndryshuar, saqë një vesh i stërvitur mund të identifikojë të folurën e shtëpisë (de Boysson & Bardies, sipas Murtezani,2006). Tash më fillojnë të zhduken fonemat jashtë gjuhës natyrore amtare. Dhe, për rrjedhim, foshnjat gradualisht fillojnë të humbasin aftësinë për të dalluar tingujt që nuk i kanë dëgjuar kurrë më parë. Eksperimentet shumë të mprehta, të realizuar nga Xhanet Uerkër (Janet Werker, sipas Murtezani,2006), zbuluan se foshnjat gjashtë - muajsh mund të perceptonin dallime të pakapshme të fonemave të gjuhëve të tjera, por që prej moshës dymbëdhjetë mujore nuk mundën më. Pa qenë të ekspozuar ndaj gjuhëve të tjera, ne bëhemi funksionalisht të shurdhët ndaj tingujve të të folurës që nuk gjenden në gjuhën tonë amtare. Për këtë arsye, në moshë të rritur ata që flasin vetëm anglisht nuk janë në gjendje të identifikojnë disa fonema të japonishtes. As të rritur japonez, të cilët nuk kanë ushtruar anglishten, nuk arrijnë të bëjnë dallimin mes tingujve r dhe l të anglishtes (japonishtja ka një bashkëtingëllore me shqiptim të ndërmjetëm midis r -së dhe l-së).

Kur janë gati të hyjnë në kopsht shumica e fëmijëve kanë një fjalor prej rreth 8000 fjalësh, mund të bëjnë pyetje, fjali mohuese dhe fjali të varura; ata kanë mësuar që të përdorin gjuhën në situata të ndryshme sociale (Berk, 1997). Ata kanë zbuluar se ekzistojnë rregulla për kombinimin e tingujve në fjalë dhe se fjalët e veçanta kanë kuptime specifike. Ata, gjithashtu, kanë arritur të zbulojnë se ka rregulla për kombinimin e fjalive të kuptimshme dhe rregulla për të marrë pjesë në dialog. Kur një fëmijë hyn në shkollë fillore është një përdorues shumë i sofistikuar i gjuhës, që vë në shfrytëzim një sistem komunikues të cilit nuk i afrohet asnjë krijesë tjetër ose kompjuter."Shpejtësia e të mësuarit të të gjithë fëmijët dhe fakti që kjo ndodh në mënyrë të përgjithshme, pa asnjë instruksion, pavarësisht dallimeve shumë të mëdha sociale dhe kulturore, ka çuar në besimin se ka disa predispozita të lindura të foshnjat njerëzore për të mësuar gjuhën" ( Yule, sipas Feldman, 1997 ). Në moshën tetëvjeçare fëmija mund të vizatojë dhe të shkruajë; fillon të kuptojë se fjalët kanë më shumë se një kuptim (top, pres).

Te fëmija i moshës nëntëvjeçare përparimi gjuhësor është më se evident. Ai përshkruan objekte në detaje; shkruan mirë; shfrytëzon përmbajtjen e fjalive për të përcaktuar kuptimin e fjalëve. Ndërkaq, në moshën dhjetëvjeçare dhe më pas, është i aftë të përshkruajë situatë sipas shkakut dhe pasojës; shkruan ese të gjatë dhe të qartë; pëlqen rrëfime shkencore dhe mistike, me një fjalë zotëron aftësi të mira folëse. Në klasa më të larta të shkollimit fillor, nxënësit janë më të aftë për komunikim me të tjerët. Ky komunikim pasqyron një përsosje procesesh të ndryshme zhvillimi: rritjen fizike, që ndërlikohet me zhvillimin e sistemit nervor dhe të organeve të të folurit; përmirësimin e proceseve mendore, përkatësisht të aftësive për të operuar me simbole dhe të kujtesës; zhvillimin gjuhësor, që pasqyrohet në pasurimin e fjalorit dhe shfrytëzimit të tij në mënyrë të përshtatshme. Këta zhvillime kulmojnë me shndërrimin e gjuhës në një mjet efikas për përshtatje në mjedis.

#### **IV. TË FOLURIT DHE EKSPERIENCA E FËMIJËS**

Në të nxënit e gjuhës në fillim të fëmijët vërehen dy stile: 1). Referues - mësohen një sasi e madhe emrash të objekteve dhe etiketime, dhe 2). Ekspresiv-një një përzierje të gjerë të tipave të fjalëve për të shprehur nevojat dhe bashkëveprimin social. Një shpjegim për këto modele të ndryshme nga njëri-tjetri është ai biologjik, sipas të cilit kemi të bëjmë pe predispozita të ndryshme të fëmijëve, por edhe se gjithë kjo është rezultat i kontekstit në të cilin realizohet të nxënit e gjuhës (McCabe, 1989). Fëmijët e referencës janë kryesisht të gjinisë femërore. Shumica e tyre janë fëmijë të parë në familje dhe në përgjithësi prindërit e tyre janë me status të lartë social ekonomik. Ato flasin ngadalë, kanë artikulum të mirë të fjalëve dhe shpejt e mësojnë gjuhën. Fëmijët ekspresiv janë më shumë të gjinisë mashkullore. Shumë prej tyre për nga renditja e lindjes janë të dytë të tretë etj., ato zakonisht i përkasin familjeve ta klasës së ulët ose punëtore , fjalët i mësojnë më ngadalë dhe artikulumi i tyre është më i dobët.

Mendohet se këto karakteristika ndikojnë mjedisin gjuhësor në të cilin zhvillohen fëmijët. Prindërit llogarite tu flasin më shumë foshnjave vajza dhe me artikulum më të mirë sesa atyre djem (Anderson , 1987). Po ashtu lloji i veprimtarive me të cilat merren fëmijët ndikon mënyrën e komunikimit me prindërit e tyre. Derisa vajza luan me kukulla , prindërit janë të prirur të përdorin më shumë emërtime që nuk ndodh derisa fëmijët e tyre merren me makina kur prindërit përdorin më pak të folurit. Pra veprimtari të ndryshme mund të ndikojnë llojin e gjuhës së bashkëveprimit të tyre me prindërit. ( O'Brien&Nagle, 1987).

Supozohet se edhe dallimet në rendin e lindjes mund të kenë rolin e tyre në këtë çështje. Në pyetje është koha të cilën prindërit ndajnë për fëmijët e tyre. Dihet se fëmijëve të parë në familje u kushtohet më shumë kujdes dhe kohë në zhvillimin e aftësive gjuhësore , përveç të tjerash, krahasua me të tjerët. Ato i marrin informacionet e para pikërisht nga prindërit tyre ndërkaq te fëmijët e dytë ndodh që më shumë të informohen nga motrat ose vëllezërit më të rritur. Po ashtu ata kalojnë pjesën më të madhe të kohës në bashkëveprim me vëllezërit dhe motrat e mëdha, të folurit te të cilëve është më pak i përsosur gjuhësor(Adamson,sipas Vasta etj., 2007).

Reagimet e te rriturve ndaj fëmijëve reflektohen edhe në mënyrën e artikulumit për të shqiptuar. Ato që flasin më ngadalë por edhe më qartë mbase kanë bashkëpunim më të shpeshtë dhe më të gjatë me prindërit e tyre se sa fëmijët tjerë që vështirë kuptohen. Kohën dhe cilësinë e stimulimit gjuhësor e përcakton edhe shtresa sociale e prindërve. Prindërit e klasës së mesme dhe të lartë shprehin interesim më të madh për të mësuarit e gjuhës nga ana e fëmijëve të tyre. Gjuha e tyre është e shoqëruar me modele më të mira dhe mjete më të ndryshme të mësimi të gjuhës, gjë që nuk haset në ligjërimin e prindërve të klasave të ulëta(Oksaar,1983).

Nga më lartë, faktorët social dhe mjedisorë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në të nxënit e gjuhës nga ana e fëmijëve(Bandura,1986; ). Zhvillimi i të folurit fëmijëror, në masë të madhe, është e përcaktuar nga sasia dhe cilësia e komunikimit mes prindërve dhe fëmijëve. Prindërit, përveç që u ofrojnë fëmijëve të tyre ngrohtësi dhe përkrahje emocionale, realizojnë një komunikim të ndërsjellë verbal. Fëmijët, të cilët për shumë arsye janë të privuar nga komunikimi gjuhësor me prindërit, rëndom pësojnë dëmtime të ndryshme në aftësitë e të shprehurit verbal. Kur këto njohuri merren së bashku japin një argument bindës për rolin e mjedisit dhe përvojës në aftësimin e fëmijës drejt përvetësimit të gjuhës.

#### **V. REZYME**

Kultura gjuhësore e mjedisit drejtpërdrejtë ndikon në shkallën e zhvillimit dhe nivelin e aftësive verbale të fëmijës. Mjedi i arsimuar i ofron fëmijës më shumë nxitje, një fond më të begatshëm fjalësh, një konstrukt të drejtë të fjalive etj.

Zhvillimin i aftësisë së të folurit, përkatësisht pasurimi i fondit foljor dhe të gjitha funksioneve simbolike, paraqet një detyrë serioze të të rriturve në edukimin e fëmijëve.

Faktorë të rëndësishëm për zhvillimin e të folurit konsiderohen ato biologjik si për shembull, shqisa e zhvilluar e të dëgjuarit, pjekuria morfologjike dhe funksionale e kores së trurit; inteligjenca dhe aftësia e të menduarit - fëmija i prapambetur në zhvillimin gjuhësor, mbase ngec në atë intelektual. Po ashtu gjendjet emocionale( eksperiencia) të fëmijës ndikojnë gjithashtu në të folurit e tij (tronditjet e fuqishme emocionale

sikurse frika, trishtimi).Traumat dhe streset mund të ngadalësojnë ecurinë e zhvillimit të të folurit, madje të shkaktojnë deformime të ndryshme të tij.

Shembujt e mësipërm dëshmojnë për ndikimin e faktorëve socialë dhe biologjikë në zhvillimin e të folurit. Për të mësuar gjuhën e të folurit është e domosdoshme prania e njerëzve tjerë që i flasin fëmijës nga njëra anë dhe pjekuria e sistemit nervor (qelizave, fijeve nervore) për ta kuptuar dhe folur gjuhën. Ekzistojnë dy stile në përvetësimin e të folurit të fëmijës: I referencës dhe ekspresiv që rezultojnë në përvetësim të shpejtë të emrave respektivisht shprehjeve për veprime. Përpos stileve të tilla, eksperiencia gjuhësore e fëmijës është e ndikuar edhe nga faktorë si që janë: rendi i lindjes, gjinia dhe shtresa sociale e prindërve.

#### LITERATURA

- [1]. **Anderson, R., Smith, B. L.** (1987). Phonological development of two year old monolingual Puerto Rican Spanish speaking children. *Journal of Child Language*, 14,57-78.
- [2]. **Bandura, A.** (1986) *Social foundation of thought and actions: Asocial cognitive theory*. Englewood Cliffs, Nj: Prentice Hall.
- [3]. **Berko, J.**(1958). The child's learning of English morphology . *Word*,14,150-177.
- [4]. **Chomsky, N.** (1965) *Aspects of the theory of syntax* .Cambridge, MA:MIT Press
- [5]. **Feldman, R.S.** (1989) *Essentials of understanding psychology*. McGraw – Hill
- [6]. **McCabe, A. E.** (1989). Differential language learning styles im young children: The importance of context. *Developmental Review*,0,1-20.
- [7]. **Murtezani, L.** (2006). *Psikologjia e zhvillimit: një vështrim përmbledhës*. Tetove : Cabej
- [8]. **Murtezani, L.** (2009) *Psihologija za srednite u~ili{ta*. Tetovo: ^abej
- [9]. **O'Brien, M.,&Nagle, K.** (1987). Parent's speech to toddlers: The effect of play context. *Journal of Child Language*,14, 269-279
- [10]. **Oksaar, E.** (1983). *Language acquisition in the early years: An introduction to paedolinguistics*. London: Bartsford Akademik and Education Ltd.
- [11]. **Pettijohn, F.T.** (1996). *Psikologjia një hyrje koncize*. Tiranë: Lilo.
- [12]. **Piaget, J** (1971) *Science of education and the psychology of the child*. New York: Wiking
- [13]. **Pinker, S.** (1990). Language acquisition. In D. N. Osherson & H. Lasnik. (Eds.). *Language*. Cambridge, MA:MIT Press
- [14]. **Pronko, N. H.** (1946). Language and psycholinguistics: a revieë. *Psychological Bulletin*, 43, May, 189-23.
- [15]. **Ross Vasta, Marshall M, Haith dhe Scott A. Miller** (2007) *Psikologjia e fëmijës*, Shkenca moderne: Uegen, Tiranë.
- [16]. **Skinner, B. F.** (1957) *Verbal behavior*. New Work. Appleton- Century –Crofts

Hulya Skuka (Phd). "Psycho-Linguistic Development of the Child: The Role of Early Experience." *IOSR Journal of Humanities and Social Science (IOSR-JHSS)*. vol. 24 no. 04, 2019, pp. 77-81.